



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

**Komisioni i Përhershëm i Veprimtarisë Ekonomike, Financiare, Buxhetit, Pronës dhe i
Zënies me Punë**

RAPORT VENDIMMARRJE

Nr.1 datë 29/09/2025

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit **“Për miratimin e raportit të monitorimit të buxhetit për periudhën janar- gusht 2025”**.

Analiza ligjore: Projekt-vendimi është i mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

Situata aktuale e funksionit Propozimi dhe miratimi i këtij vendimi është kërkesë e Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” udhëzimin nr.22 datë 30.07.2018“ Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore” dhe si e tillë ai vjen në kohën e duhur në zbatim të ligjit.

Situata financiare : Raporti i dytë i Monitorimit të buxhetit prezanton planifikimin/realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për 8-mujorin e parë të vitit në nivel programi, llogari ekonomike (600-231) për buxhetin e vitit 2025.

Drejtoria / Sektori përgjegjës – Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Ceshtjeve Sociale si dhe drejtoritë e tjera të bashkisë që mbulojnë cdo sektor.

Monitorimi dhe raportimi : Drejtoria e Buxhetit, Menaxhimit Financiar dhe Ceshtjeve Sociale monitoron dhe pergatit raportet per Keshillin e Bashkisë dhe Ministrinë e Financave.

Impakti social / grupet që preken: Rritja e transparencës publike(qytetarët marrin informacion më të qartë se si përdoren fondet) ,rritja e efikasitetit të shërbimeve publike (identifikohen shpenzimet joefektive dhe korrigjimi në kohë i tyre) .

A është objekt i konsultimit publik: Projekt-vendimi nuk është objekt i konsultimit publik .

“ Komisioni i Përhershëm i Veprimtarisë Ekonomike, Financiare, Buxhetit, Pronës dhe i Zënies me Punë ” , i mbledhur me datën 29/09/2025 shqyrtoi projekt vendimin “Për miratimin e raportit të monitorimit të buxhetit për periudhën janar- gusht 2025”, relacionin dhe dokumentat shoqërues paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese, Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak: **Miratimin e projektaktit**

Bashkëlidhur procesverbali i mbledhjes së Komisionit

Ndriçim Doda Kryetar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)

Leut Bahiti Sekretar i Komisionit

(emri, mbiemri, firma)



Datë 29/09/ 2025